



01 Nr. 499/25 Dt. 15.08.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), , nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, Marrëveshjes së Sponsorizimit të nënshkruar ndërmjet Shoqatës “Aces Europe” me qendër në Bruksel (Belgjikë) dhe Komunës së Prizrenit, datë 17.12.2024, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesë të faturës nr. 922025 të Shoqatës “Aces Europe” (Shoqatë e cila promovon politika sportive evropiane përmes ndarjes së çmimeve ndërkombëtare si Kryeqytet Evropian) me qendër në Bruksel (Belgjikë), e cila është faturuar konform Marrëveshjes së Sponsorizimit të nënshkruar ndërmjet Shoqatës “Aces Europe” me qendër në Bruksel (Belgjikë) dhe Komunës së Prizrenit, datë 17.12.2024, pas zgjedhjes së Komunës së Prizrenit si “City of Sports 2026”, pagesa e shumës monetare prej 10.000,00 (dhjetë mijë euro) bëhet për të drejtat e imazhit, komunikimin dhe përdorimin e logos dhe etiketës së çmimit të ACES Europe, sipas dispozitave të nenit 26.4 të Rregullores së Përgjithshme të ACES Europe andaj, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 10.000,00 € (dhjetë mijë euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Sponsorizimit të nënshkruar ndërmjet Shoqatës “Aces Europe” dhe Komunës së Prizrenit, datë 17.12.2024.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
4. Mjetet e lartcekura, si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të alokohen (bëhet pagesa) në xhirollogarinë nr. –IBAN: BE51 0018 5806 0662 BIC: GEBABEBB, Aces Rond Pount Robert Schuman, 6 Box 5. 1040-Brusswl, BE0831576545, Belgium.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.